



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

Në pajtim me nenin 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës të Kosove, Ligjin nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Rregulloren nr.01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, Rregulloren e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit nr.02/2016 dhe Rregulloren nr.02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionit të Avokatit të Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

**K O N K U R S**

**I. Titulli i vendit të punës:** Këshilltar i lartë juridik për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, një (1) pozitë

Numri i referencës: 3/2017

Grada/Koeficienti: Niveli Profesional – G3/16.77

Mbikqyrësi: Drejtori departamentit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1(një) vjeçare.

Vendi: Prishtinë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:**

1. Pranon dhe trajton ankesat për shkeljet e pohuara të të drejtave të fëmijëve, veçanërisht të dhunës kundër fëmijëve dhe në përputhje me procedurat e parapara, përgatit përgjigjen me shkrim për refuzimin e ankesës apo hedhjen poshtë të saj si të pabazuar në rastet kur ankesa: nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit; është parashtruar pas afatit të paraparë me ligj; është anonime dhe e pa dokumentuar; paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës dhe se ankuesi ka dëshmuar se nuk mundë të sigurojë informatat shtesë të kërkuara, dhe të njëjtën ia përcjell drejtorit te departamentit per veprim te mëtejme.
2. Analizon ankesat e pranuar dhe përgatit vendimet për fillimin e hetimeve, kur ekziston dyshimi i bazuar për shkeljet e pohuara të të drejtave të fëmijëve, qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me vet iniciativë (ex officio), dhe të njëjtën, ia përcjell drejtorit të departamentit për shqyrtim dhe komunikim paraqitësit të ankesës dhe autoritetit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
3. Përgatit rekomandimet, që autoriteti kompetente të pezullojnë ekzekutimin e vendimit të ankimuar deri në përfundimin e hetimeve, nëse gjatë hetimeve, konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për të drejtat e fëmijëve, dhe të njëjtën i'a përcjell drejtorit të Departamentit për shqyrtim dhe veprim të mëtejme.
4. Përgatit kërkesën drejtuar organeve të prokurorisë dhe të hetimit, ne rastet kur konstatohet se ka ndodhur shkelja e pohuar e të të drejtave të fëmijëve nga subjektet e sektorit publik dhe privat, për fillimin e hetimeve dhe të njëjtën ia përcjell drejtorit te departamentit per veprim te mëtejme.
5. Kontakton institucionet përkatëse, kryen verifikimet e nevojshme lidhur me pohimet e parashtruara në ankesë, kompletion dokumentacionin dhe provat materiale per veprim sipas ankesës, ndërmjetëson dhe ndërmerr të gjitha veprimet e tjera të nevojshme procedurale dhe teknike që paraqiten në fazën e hetimit të ankesave, dhe mbi bazën e natyrës së tyre dhe analizës së kryer, përvojës së krijuar dhe ekspertizës, identifikon pengesat dhe problemet, raporton, rekomandon dhe propozon masat për zgjidhje dhe përmirësime përkatëse.
6. Ndhmon në hartimin e procedurës së veçantë për pranimin dhe trajtimin e ankesave të pranuar edhe nga fëmijët, dhe asiston në përpilimin e Programit të përhershëm që fëmijët të bëhen të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të tyre, dhe të njëjtat, nëpërmjet zëvendësit të Avokatit të Popullit, ia përcjell Avokatit të Popullit për shqyrtim dhe aprovim.
6. Propozon masa në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, në veçanti atyre që janë viktime të dhunës, në mënyrë që të gjithë fëmijët, pa asnjë dallim, të mundë të mbrohen kundrejt të gjitha formave të dhunës, dhe të njëjtat ia përcjell drejtorit të Departamentit për shqyrtim dhe veprim të mëtejme.
7. Ndhmon në ndërmarrjen e masave për përmirësimin e punës së institucioneve në fushën e realizimit dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, harton raporte dhe identifikon dokumentet, ligjet dhe rregulloret për ndryshim dhe përplotësim për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

8. Përcjell jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, praktiken vendore gjyqesore, si dhe standardet tjera të drejtave të njeriut, për rastet e gjykuara të drejtave të femijeve, me qëllim përgatitjeje dhe evitimi (parandalimi) të procedurave të tilla përmes mbrojtjes në kohë të drejtave të palëve të dëmtuara dhe dhënien e ndihmës organeve të administratës të cilat vendosin mbi të drejtat dhe liritë e qytetarëve që në kohën e caktuar dhe në mënyrë të ligjshme të veprojnë
9. Përgatitë rekomandime dhe propozime, mbi bazën e hetimeve të zhvilluara, për fillimin e procedurës disiplinore kundër një punonjësi të një organi administrativ i cili, me veprimin apo mosveprimin e tij, është drejtpërdrejt përgjegjës për shkeljen e të drejtave të fëmijëve.
10. Udhëheq grupet punuese në çështjet profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë, ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda IAP-it si dhe ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda departamentit për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
11. Merr pjesë në seminare, trajnime dhe konferenca, në suaza të trajtimit të çështjeve nga fushveprimtaria e departamentit dhe temave që ndërlidhen me të drejtat e fëmijëve dhe përgjegjësi.
12. Merr pjesë në përgatitjen e Planit Vjetor të punës së Departamentit, përpilon raporte të rregullta pune në baza mujore, tremujore dhe vjetore, dhe sipas kërkesave të menagjmentit, bënë analiza të veçanta nga fusha e përgjegjësive të departamentit.
13. Kryen detyra tjera – në përputhje me ligjet dhe rregulloret momentale – të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe

#### **Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në shkencat juridike.
- Minimum 3 (tri) vjet përvojë pune profesionale.
- Njohje të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe, ndërsa preferohet njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar.
- Trajnime përkatëse në fushën e të Drejtave të Njeriut.
- Vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale, jo më i vjetër se 6 muaj.

---

#### **Procedura e konkurimit**

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org).

Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me Konkurs personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Migjeni“, nr. 21, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën [zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org](mailto:zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org), si dhe me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

#### **Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga pjestarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 21 shkurt 2017, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët që kanë aplikuar, por nuk janë përzgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit. Dokumentet që nuk tërhiqen administrohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782.